



Prishtinë, 10 dhjetor 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1321_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084),
- Nenin 9 par. 1 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtritshme të Energjisë të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së,
- Nenin 3 par. 1 nënpar. 1.6 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017 për caqet e Burimeve të Ripërtritshme të Energjisë deri në vitin 2020 të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik,
- Konkluzionet e takimit 15 të Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë, të datës 14 dhjetor 2017,

në seancën e mbajtur me datë 10 dhjetor 2020 nxori këtë:

V E N D I M

- I. NDËRPRITET –** Aplikimi i Skemës Mbështetëse me Tarifa Nxitëse (“Feed - in”) për mbështetjen e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtritshme të Energjisë (BRE).
- II. Ndërpritet** pranimi aplikacioneve për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese, për tu trajtuar me tarifë nxitëse “feed - in” nga Burimet e Ripërtritshme të Energjisë me datën e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
- III. Deri më datën e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, të gjitha aplikacionet të pranuar dhe regjistruara në ZRRE dhe që janë brenda caqeve të BRE-ve deri në vitin 2020, do të trajtohen sipas kornizës ligjore/rregullative në fuqi në kohën e aplikimit.**
- IV. Vendimet për Autorizim Preliminar apo Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese që janë lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, do të trajtohen sipas dispozitave ligjore të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse dhe Vendimit V_810_2016 të datës 19 maj 2016 të nxjerr nga Bordi i ZRRE.**
- V. Aplikuesit që janë të pajisur me Autorizime Preliminare dhe që janë përfshirë në listën e pritjes si aplikacione “në pritje”, përtej caqeve të BRE-ve, nuk do të trajtohen me tarifa nxitëse “feed-in” nga Zyra e Rregullatorit për Energji.**
- VI. Vendimi Nr. V_1204_2019 i datës 27 nëntor 2019 i nxjerr nga Bordi i ZRRE-së, nuk zbatohet si pasojë e pezullimit nga ana e Gjykatës, deri në shqyrtimin e çështjes kryesore me Aktgjykim meritor nga gjykata kompetente dhe Vendimin Nr. 17/2020 të datës 24 dhjetor 2020 të**



Komisionit për Ndhimë Shtetërore me të cilën është konstatuar si ndihmë shtetërore e ndaluar dhe nuk e ka autorizuar, konform nenit 14 (1.3) të Ligjit për Ndhimën Shtetërore.

- VII. ZRRE në pajtim me detyrimet ligjore dhe në bashkëpunim me Institucionet e Republikës së Kosovës, do të ndërmarr veprime për zhvillimin e projekteve nga Burimet e Ripërtrishme të Energjisë për caqet 2021-2030 përmes formave të ndryshme të ankandeve, në përzgjedhjen e përfitueseve nga format tjera mbështetëse përmes Tarifave Premium ose të ngjashme, konform praktikave më të mira në favor të interesit publik.

Arsyetim

- o ZRRE, ka vlerësuar se zhvillimi i teknologjive për prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtrishme të energjisë është zhvilluar shumë gjatë dekadës së fundit dhe trendi i zhvillimit të tyre do të vazhdon edhe në të ardhmen.
- o ZRRE poashtu ka vlerësuar se duhet të ndiqen trendët e zhvillimeve të përgjithshme në sektorin e energjisë dhe t' i përshtaten politikave të transformimit të ndjeshëm në tregun e energjisë elektrike në rajon dhe më gjerë. Një nga transformimet më të rëndësishme, padyshim është zhvillimi i teknologjive të BRE-ve, e në veçanti atyre solare dhe të erës, duke ndikuar kështu në rënien drastike të kostos së investimeve në këtë sektor, si dhe duke ngritur efikasitetin e shfrytëzimit të teknologjive në fjalë.
- o Poashtu si rezultat i këtyre zhvillimeve teknologjike, ZRRE ka arritur në përfundim se mbështetja e investimeve në energjinë e ripërtrishme përmes tarifave nxitëse ("Feed – in") tanimë nuk është e nevojshme në raport me disa vite më parë, marr parasysh edhe zhvillimet në shumë vende evropiane dhe të rajonit, ku tarifa nxitëse ("Feed-in"), si masë dominuese tanimë përjashtohet nga skemat mbështetëse, duke u zëvendësuar me modele të reja të cilat përafrojnë çmimet e energjisë nga BRE me ato të tregut.
- o Si rrjedhojë, ZRRE ka vlerësuar se zhvillimi i teknologjisë patjetër që ka ndikim edhe në politikat e Kosovës në drejtim të mbështetjes së BRE-ve, duke i orientuar në masë të pranueshme kah tregu i energjisë përmes skemave të ankandeve dhe duke lejuar tregun që të përcaktoj se çfarë çmime do të ishin të arsyeshme për energjinë e prodhuar nga BRE.
- o Poashtu ZRRE ka vlerësuar se kostot e investimeve dhe çmimet e përcaktuara nga vet tregu, përmes mënyrave konkurruese apo të ankandeve do të krijonin mundësi të barabartë për investime ndaj të gjithë investitorëve potencial dhe të zhvilloj modele konkurruese për zhvillimin e sektorit të BRE-ve.
- o Poashtu edhe konkluzionet e takimit të 15 të Këshillit Ministror të mbajtur me datë 14 dhjetor 2017 kanë inkurajuar Palët Kontraktuese, ku bën pjesë edhe Republika e Kosovës, që të punojnë ngushtë me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë (SKE) dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në hartimin dhe zbatimin e procesit konkurrues, efikas dhe transparent për dhënien e skemave mbështetëse për burimet e ripërtrishme të energjisë.
- o ZRRE poashtu ka marr parasysh edhe fillimin e zbatimit të Projektin për zhvillimin e Ankandit për BRE-të financuar nga BERZH, i cili ka për detyrë hartimin e procedurave për implementimin e Ankandit për BRE-të dhe i cili pritet të filloj të implementohet gjatë vitit 2021.



- o ZRRE gjithashtu ka marrë në konsideratë Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017 i cili ka përcaktuar caqet e Burimeve të Ripërtitshme të Energjisë deri në vitin 2020 dhe i cili pritet të zëvendësohet me Caqe të reja të BRE për 2021-2030.
- o Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të situatës aktuale dhe të gjitha këto që u thanë më lartë, ka vlerësuar se duhet të ndërpritet aplikimi i Skemës Mbështetëse me Tarifa Nxitëse ("Feed in") për mbështetjen e ndërtimit të kapacitete të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE, dhe të shkohet përmes skemave tjera konkurruese, andaj duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

- I. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. kryesues


Besim Sejfićaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit,
- KOSTT,
- KEDS,
- KESCO, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.